



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve

Data: 30.05.2023

Nr: 168

Ora: 16:15

**VENDIM**

**PËR KTHIMIN E KËRKESËS ANKIMORE NR. 71, TË DEPOZITUAR NË KQZ NË DATËN 22.05.2023  
NGA SUBJEKTI ZGKEDHOR "BINDJA DEMOKRATIKE"**

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve në mbledhjen e datës 30.05.2023, me pjesëmarrjen e:

Koli	BELE	-	Relator
Elvin	LAKO	-	Anëtar
Elvis	ÇEFA	-	Anëtar
Ilirjan	RUSMALI	-	Anëtar
Ledio	BRAHO	-	Anëtar

Shqyrtoi çështjen me:

**ANKUES:** Subjekti zgjedhor partia "Bindja Demokratike"

**OBJEKT:** 1.Rinumërim i kutive për QV nr. 0522, 0473, 0476, 0477 dhe 0499 për këshillin bashkiak Tropojë, dhe ndryshimi i tabelës përmbledhëse sipas rezultatit të dalë nga rinumërimi

**BAZË LIGJORE:** Nenet 21, 124, 126, 129 dhe 130 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar



Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur,

### **VËREN:**

Subjekti zgjedhor partia “Bindja Demokratike” ka depozituar pranë Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve kërkesën ankimore, e cila është regjistruar në regjistrin e kërkesave për masat disiplinore, me nr. 71 regj., datë 22.05.2023.

Në mbledhjen e datës 30.05.2023, ora 16:15, pas relatimit të z. Koli Bele u konstatua se kërkesa ankimore nuk i plotësonte elementet e formës të parashikuara në nenin 126, pasi është paraqitur me të meta. Konkretisht në ankim nuk është bashkëlidhur asnjë provë për të provuar pretendimet e subjektit ankues, sipas parashikimit të nenit 126, pika 1, shkronja “dh” të Kodit Zgjedhor; gjithashtu nuk është referuar vendimi objekt ankimi sipas përcaktimeve të shkronjës “b” të nenit 126, pika 1.

Në bazë të nenit 129, pika 1, të Kodit Zgjedhor, KAS për çdo kërkesë ankimore të regjistruar bën verifikimin e ekzistencës së elementeve të formës sipas nenit 126 të Kodit Zgjedhor dhe të elementeve të përcaktuara në nenin 130 të po këtij Kodi. Në kushtet kur kërkesa ankimore objekt i kësaj procedure të plotësimit të formës dhe përmbajtjes nuk i plotëson kushtet e shkronjës “b” dhe “dh” të pikës 1, të nenit 126, të Kodit Zgjedhor, ajo duhet t’i kthehet për plotësimin e elementeve të formës, sipas përcaktimeve të cituara si më sipër.

### **PËR KËTO ARSYE:**

Bazuar në nenin 129, pika 3, shkronja “c” të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve,

### **V E N D O S I:**

1. Kthimin e kërkesës ankimore nr. 71, datë 22.05.2023 për plotësim të elementëve të formës.
2. Seanca paraprake do të zhvillohet më datë 31.05.2023, ora 16:30.

3. Ngarkohet administrata e KQZ-së me njoftimin e këtij vendimi palës në mungesë dhe me zbatimin e tij.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe përfundon me çeljen e seancës së shqyrtimit paraprak, sipas shkronjës “b”, të nenit 68 të Kodit të Procedurave Administrative.

U shpall sot më datë 30.05.2023.

**Koli**            **BELE**            -            **Relator**

**Elvin**            **LAKO**            -            **Anëtar**

**Elvis**            **ÇEFA**            -            **Anëtar**

**Ilirjan**            **RUSMALI**            -            **Anëtar**

**Ledio**            **BRAHO**            -            **Anëtar**